

VENDIM
Nr.255, datë 27.2.2008

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË TJERA STUDIMI PRANË SHKOLLËS SË LARTË
UNIVERSITARE PRIVATE “UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e shkollës së lartë universitare private “Universiteti European i Tiranës”, Tiranë, për hapjen e Fakultetit Ekonomik, me programet e studimit të ciklit të parë, në formën e studimeve me kohë të plotë, për:

- a) ekonomik;
- b) financë-bankë;
- c) menaxhim biznesi;
- ç) administrim publik.

2. Kohëzgjatja e secilit program do të jetë nga 3 vjet. Në përfundim të programeve të studimeve lëshohet diploma e nivelit të parë (DNP), në fushën e arsimimit të kryer.

3. Ngarkohet “Universiteti European i Tiranës” që, për çdo program studimi, të sigurojë, nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale, zhvillimin e disa prej disiplinave kryesore formuese të specialitetit, pas vitit të parë, nga një personel akademik i huaj, me kualifikimin e nevojshëm.

4. Universiteti European i Tiranës do ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se dy javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Ministri e lëshon lejen pasi vlerëson se institucioni privat i arsimit të lartë ka përmbushur angazhimet e deklaruara, në përputhje me udhëzimin e tij, për këtë qëllim.

5. Ndryshimet në vendndodhje, plane, forma studimi dhe programe, si dhe në elemente të tjera të miratuara bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

6. Universiteti European i Tiranës duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të këtyre programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

7. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha